



BURSAT E TEKNOLOGJISË NË UNIVERSITETIN E KLAGENFURT

Agjencia e Austrisë për Arsimin dhe Ndërkombëtarizimin, OeAD, ka hapur aplikimet për thirrjen e katërt për Bursat e Teknologjisë në Universitetin e Klagenfurt.

Afatet e aplikimit për këtë program inovativ të bursave në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikacionit (IKT), në bashkëpunim me OeAD, janë jo më larg se data **5 qershor 2021, në formatik elektronik përmes faqes web të OeAD.**

Ky program ofron studime të nivelit II, planifikuar për semestrin veror 2022, për të gjithë personat e interesuar që zotërojnë një diplomë bachelor në Shqipëri. Studimet përfshijnë fushat e mëposhtme:

- Master në Matematikë;
- Master në Inxhinieri dhe Studimet e Lojërave (Gaming);
- Master në Informatikë;
- Master në Menaxhimin e Informacionit;
- Master në Inxhinierinë e Informacionit dhe Komunikimit (ICE):
 - Dega e Studimit Sisteme Autonome dhe Robotikë;
 - Dega e Studimit Rrjetet dhe Komunikimet;
 - Dega e Studimit Inxhinieria e Biznesit.

Niveli i njohurisë së gjuhës angleze duhet të jetë B2 ose C1, në varësi të programit të përzgjedhur të studimit.

E veçanta e programit është që bursistët, mund të përfitojnë një praktikë të paguar në një kompani në Kärnten në vitin e dytë. Dhoma e Tregtisë Kärnten (WKO Kärnten) dhe Federata e Industrisë (IV Kärnten) mbështesin procesin e shpërndarjes së vendeve si dhe ndërmjetësimin e tyre.

Aplikimet do të bëhen vetëm në formë elektronike përmes webfaqes OeAD, në gjuhën angleze:

<https://grants.at/en/>

Për më shumë informacion klikoni linkun e mëposhtëm:

https://oead.at/fileadmin/Dokumente/oead.at/ICM/Allgemeine_Dokumente/FLYER_University_of_Klagenfurt_Technology_Scholarship_S_22.pdf

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS